

VENDIM
Nr. 48, datë 1.9.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR FUNKSIONIMIN E REGJISTRIT TË KREDIVE NË BANKËN E SHQIPËRISË, SI DHE KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR NJOHJEN, PËRDORIMIN DHE RISHIKIMIN E TË DHËNAVE QË ADMINISTROHEN NË TË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c” dhe nenit 22, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neneve 126 dhe 127, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”; nenit 106, të ligjit nr. 52, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim kreditit dhe unionet e tyre”; ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë, si dhe kushtet dhe procedurat për njohjen, përdorimin dhe rishikimin e të dhënave që administrohen në të”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 72, datë 2.12.2020, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

I. Në aneksin 3, “I” Skedari i kredive të disbursuara, shtohen fushat SKE1058 dhe SKE1059

SKE1058	NEI	Decimal (13, 2)	Norma efektive e interesit Fushë e detyrueshme kur SKE1003=0 “Individë”
SKE1059	Përjashtimet nga mbrojtja për kredinë konsumatore	Numeric (0-6)	Fushë e detyrueshme kur SKE1003=0 “Individë” dhe kur SKE1032= 0,1,2,6
			0. Kredi të siguruara me pronë të paluajtshme (hipotekë) Që janë të siguruara me anë të hipotekës ose nga ndonjë sigurim tjetër i krahasueshëm, që përdoret zakonisht mbi pronën e paluajtshme, apo të siguruara nëpërmjet një të drejte që lidhet me pronën e paluajtshme
			1. Qira financiare pa detyrim për blerjen e objektit Marrëveshjet e qirasë ose lizingut ku detyrimi për blerjen e objektit të marrëveshjes nuk është përcaktuar në vetë marrëveshjen ose në ndonjë marrëveshje të veçantë. Një detyrim i tillë do të prezumohet se ekziston, nëse është vendosur kështu në mënyrë të njëanshme nga kreditori.
			2. Kredi me kosto totale 0 Ku kredia është dhënë pa interes dhe pa ndonjë detyrim/pagesë tjetër dhe marrëveshjet e kredisë, sipas kushteve të të cilave kredia duhet të shlyhet brenda tre muajve dhe janë për t’u paguar vetëm detyrime me vlerë të vogël, të papërfillshme .
			3. Kredi për punonjësit e subjektit me norma preferenciale Ku kredia është dhënë nga punëdhënësi

			punonjësve të tij, si një veprimtari dytësore pa interes ose me një normë vjetore të përqindjes së pagesave/detyrimeve më të ulët se ato që ekzistojnë në treg dhe që përgjithësisht nuk janë të ofruara për publikun.
			4. Kredi e garantuar me depozitë/shumë monetare Prej lidhjes së të cilave konsumatorit i kërkohet që të depozitojë një send si siguri në ruajtje të kreditorit dhe ku përgjegjësia e konsumatorit ndaj këtij sendi të lënë peng është rreptësisht e kufizuar.
			5. Kredi të dhëna në bazë të një dispozite ligjore me interes të subvencionuar Që kanë të bëjnë me huat e dhëna ndaj një publiku të kufizuar, në bazë të një dispozite ligjore, me qëllim të interesit të përgjithshëm dhe me norma interesi më të ulëta se ato që ekzistojnë në treg, ose pa interes, apo në kushte të tjera që janë më të favorshme për konsumatorin se ato që ekzistojnë në treg dhe me norma interesi jo më të larta se ato që ekzistojnë në treg.
			6. Asnjë nga pikat më lart

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko